



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 344/7 prot.

Tiranë, më 31.10.2022

**VENDIM**  
**Nr.131, datë 31.10.2022**

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 120, DATË 12.10.2022, NË INSTITUCIONIN  
MINISTRIA E BRENDSHME**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike, Integritimit dhe Studimeve, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 120, dt. 12.10.2022, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria Brendshme, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*,

**KONSTATOVA SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Ministrisë së Brendshme, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 4533/1 prot., datë 24.05.2022, ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Ministrisë së Brendshme, vendimin paralajmëruar me Nr. 120, dt. 12.10.2022, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Brendshme, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Ministria e Brendshme, me shkresën nr.10586/4 prot., datë 24.10.2022, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur Ministria e Brendshme, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësin \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse*”, në Ministrinë e Brendshme.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 120, dt. 12.10.2022, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Brendshme, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Ministria e Brendshme.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Ministria e Brendshme dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**